



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AAB Construction" Sh.P.K. të datës 14.07.2025 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AAB Construction" Sh.P.K. të datës 14.07.2025 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1 ashtu që **ANULOHE** njoftimi mbi vendimin i datës 07.07.2025 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AAB Construction" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Progovc" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Në kemi dorëzuar pajisjen (File-8.Paisjet.pdf- Faqe-13-21) sipas kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, të cilat i gjeni të bashkangjitura sërish me këtë kërkesë.

Me ofertën tonë kemi bashkangjitur të gjitha dokumentet që e prezantojnë paisjen:

- Marrëveshjen për shfrytëzimin e kësaj pajisjeje, të lidhur me kompaninë **UDHA SH.P.K.**
- Fotografinë e pajisjes
- Lejen e qarkullimit – **AA409XM**
- Certifikatën mbi pronësinë e mjetit rrugor
- Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit rrugor
- Dokumentin që vërteton pagesën e taksës vjetore të mjetit
- Certifikatën e regjistrimit të kompanisë **UDHA SH.P.K.**
- Licencën e kompanisë **UDHA SH.P.K.**

Pasija është e regjistruar, e kontrolluar dhe i përmbush të gjitha kriteret për qarkullim rrugor në bazë të Ligjit, Nr.8378, datë 22.07.1998- KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Neni 79 -Kontrolli teknik -Të bashkangjitur e gjeni me kërkesën ku shumë qartas në këtë nen janë të qartësuar procedurat për regjistrim dhe kontroll të paisjeve.

Arsyet eliminuese të parashtruesit sipas letrës standarde janë si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si OF-ik nuk keni oferte të papërgjegjshme për arsyes se GOE-ik me ofertën e tij nuk ka dorëzuar sipas kërkesës se DT-se dhe njoftimit për kontratë:
pika 4. d) 1(Një) automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid)
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që j. në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qiramarrjen për këtë projekt, ju në ofertën tuaj keni paraqitur paisie tjetër në kundërshtim, për këtë arsye oferta e juaj është e pa përgjegjshme.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 par. 4 si dhe nenin 62 të LPP me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të pjesërisht qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.07.2025


Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.